

Lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit ka rrezik të përhapet



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së "ORGANIZATË TERRORISTE"? (3) ■ FAQE 4-5

MANIPULIMI SERB ME LISTAT E TË VRARËVE, TË RRËMBYERVE DHE TË ZHDUKURVE GJATË LUFTËS NË KOSOVË

- Adem Demaçi: "Vrasja e civilëve ka shërbyer për t'ia prezantuar botës se shqiptarët vrasin njerëz të pafajshëm, të cilët, në asnjë mënyrë, nuk janë të përfshirë në operacione luftarake".



- Jakup Krasniqi: "Që nga themelimi i saj UÇK-ja është distancuar nga aktet e dhunshme ndaj civilëve, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për shqiptarë, serbë apo të tjerë që jetojnë në Kosovë".



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive për "Epokën e re", në vazhdimin e pjesës së tretë, ka folur për

manipulimin e Serbisë me listat e të vrarëve, të rrëmbyerve dhe të zhdukurve gjatë luftës në Kosovë. Ai ka theksuar se pas përfundimit të luftës, propaganda zyrtare

serbe u përpoq ta hiqte përgjegjësinë shtetërore për krimet më të përbindshme që ishin kryer gjatë zbatimit të politikës së gjenocidit në Kosovë

AKTUALE



BE-ja: SERBIA TË BASHKËPUNOJË PA KUSHTE PËR HETIMIN E SULMIT NË BANJSKË F. 6

OSMANI VLERËSON ANGAZHIMIN E SHTUAR TË NATO-S PËR RITJEN E SIGURISË NË KOSOVË F. 7

UNIVERSITETI I PRISHTINËS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN DRAKE NË IOWA F. 7

EKONOMI



ATK-ja U BËNË THIRRJE PERSONAVE QË MERREN ME AKTIVITETE AFARISTE TA PAGUAJNË TATIMIN F. 8

GUVERNATORI I BQK-SË PO MERR PJESË NË TAKIMET VJETORE TË FMN-SË DHE TË BB-SË F. 8

SPORT



GLIHA: ANDORRA, NJË KUNDËRSHTARE E VËSHTRË F. 10

NJË TJETËR SKANDAL NË GJYKATËN SPECIALE



Emmersoni thotë se dëshmitari i radhës ka tentuar të negociojë me ZPS-në një pako përfitimi për të në këmbim të dëshmisë

Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka paraqitur një tjetër dëshmi që duket se përbën skandalin e radhës të Gjykatës Speciale në Hagë në gjyqin kundër krerëve të

UÇK-së. Ai ka thënë se në shënimet përgatitore të dëshmitarit të radhës, dëshmitari tenton të negociojë me Prokurorinë një pako përfitimi për të në këmbim të dëshmisë

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit ka rrezik të përhapet

JERUSALEM, 9 TETOR - Një luftë e re në tetor. Mbi 1 000 njerëz të vrarë që dy ditë, të plagosur, pengje e shkatërrime gjithandej. "Sulmi më i keq kundër Izraelit që nga Lufta Yom Kipur", tha sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, duke iu referuar luftës arabo-izraelite të vitit 1973, e njohur si Lufta e Tetorit.

E gjitha filloi më 7 tetor, kur militantët palestinezë të Hamasit sulmuan papritur Izraelin nga Rripi i Gazës. Mijëra raketa u hodhën në lagje të banueshme, luftëtarët hynë brenda komuniteteve, vranë banorë dhe morën pengje.

Në përgjigje, ushtria e Izraelit nisi sulmet nga ajri në Rripin e Gazës, ndërsa qeveria e vendit shpalli zyrtarisht luftë kundër Hamasit. "Izraeli do t'i hakmerret fuqishëm Hamasit. Kjo luftë do të marrë kohë. Do të jetë e vështirë", tha kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, të dielën e 8 tetorit.

Arsyet e sakta të sulmit të Hamasit nuk janë të qarta, por dhuna mes dy palëve ka qenë në rritje prej muajsh.

Komandanti i Hamasit, Mohammed Deif, u bëri thirrje palestinezëve dhe arabëve të tjerë që t'i bashkohen operacionit të grupit kundër Izraelit.

Por, është e paqartë nëse palestinezët në Bregun Perëndimor dhe Jerusalemin Lindor apo gjetkë në rajon, do ta dëgjojnë thirrjen e tij.

Askush "nuk dëshiron të shohë ndonjë përshkallëzim rajonal", tha kryeministri britanik Rishi Sunak. Ai tha se Hamasi dhe mbështetësit e tij janë "plotësisht përgjegjës për aktin e tmerrshëm të terrorit" në Izrael, për "vrasjen e civilëve dhe rrëmbimin e njerëzve të pafajshëm".

Kush mund të përfshihet?

Një skenar i keq do të ishte përfshirja e grupit të fuqishëm militant libanez, Hezbollah. I parë si kërcënim i madh nga Izraeli, grupi mbështetet prej vitësh nga Irani dhe ka lidhje të ngushta me Hamasin. Të dielën në mëngjes Hezbollahu lëshoi një numër raketash dhe predhash në veri të Izraelit, por pa shkaktuar viktima. "Nëse Izraeli dërgon trupa tokësore në Gazë ose bën diçka tjetër drastike, atëherë Hezbollahu mund të hapë një front në Liban dhe ta mbrojë vendimin e tij duke thënë se nuk ka zgjidhje, duhet ta mbrojë Palestinën", tha për "France24", Hussein Ibish, nga Instituti i Shteteve Arabe të Gjirit. "Do të mund ta shohim Izraelin në një luftë me shumë fronte, me grupe të ndryshme të

rezistencës - shumica e tyre nën kontrollin e Iranit", tha ai.

Sulmi i papritur palestinez ngjall frikë për "një luftë më të gjerë në Lindjen e Mesme", shkroi Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë. "Irani është, sigurisht, mbrojtës i Hezbollahut [si dhe i grupeve të tjera militante palestineze]. Ekziston një rrezik gjithnjë e më i madh për një konflikt me dy fronte, i cili do të shkatërronte pjesë të Izraelit dhe një pjesë të madhe të Libanit, ku është i bazuar Hezbollahu. Ekziston rreziku i përshkallëzimit", vlerësoi instituti me seli në Nju-Jork.

Irani, armik i betuar i Izraelit, ishte ndër vendet e para që mirëpriti ofensivën e Hamasit kundër Izraelit.

Izraeli prej vitësh e akuzon atë për furnizimin e grupeve militante me armë dhe me inteligjencë. Presidenti iranian Ebrahim Raisi tha se vendi i tij e mbështet mbrojtjen legjitime të kombit palestinez, duke shtuar se Izraeli dhe mbështetësit e tij "janë përgjegjës për paqëndrueshmërinë në rajon" dhe se ata "duhet të mbajnë përgjegjësi për këtë çështje". Ai u bëri thirrje qeverive myslimane "ta mbështetin kombin palestinez".

Sipas një analize të Këshillit Atlantik, nëse Hezbollahu përfshihet në konflikt, "Izraeli do të përballlet me një luftë mbarëkombëtare që nuk e ka përjetuar tash e sa dekada". "Ditët dhe javët e ardhshme ka të ngjarë të përcaktojnë jo vetëm të ardhmen e sigurisë së Izraelit, por ato mund ta përcaktojnë edhe të ardhmen e pozitës së tij në rajon", thuhet në këtë analizë. Hezbollahu, sipas gazetës "Financial Times", ka një arsenal raketash shumë më të madh dhe më të sofistikuar se Hamasi, i cili tenton të mbështetet në raketat e bëra vetë. "Përfshirja e tij në konflikt do të kërcënonte



Izraeli urdhëron rrethimin e plotë të Gazës

Ministri i Mbrojtjes i Izraelit, Yoav Gallant, ka thënë të hënën se e ka urdhëruar "rrethimin e plotë" të Rripit të Gazës, duke shtuar se autoritetet do ta ndërpresin rrymën si dhe nuk do ta lejojnë futjen e ushqimit e as karburanteve. Izraeli e kontrollon hapësirën ajrore mbi Gaza dhe vijën bregdetare të saj, si dhe kufizon se kush dhe çfarë mallrash lejohen të futen brenda pikave kufitare dhe të dalin jashtë tyre. Izraeli deklaroi luftë formalisht të dielën dhe i dha ushtrisë dritën jeshile për "hapa të mëdhenj ushtarakë" për t'u hakmarrë ndaj Hamasit për sulmin befasues të së shtunës.

ta mposhte sistemin mbrojtës të Kupolës së Hekurt të Izraelit". "Hezbollahu ia përgjaku hundën Izraelit gjatë konfliktit njëmuajor në vitin 2006 dhe ai fitoi përvojë në fushëbetë, pasi ndërhyri në luftën civile të Sirisë për ta mbështetur presidentin Bashar al-Assad", shkroi Financial Times. "Sky News" kujtoi se marrëveshja e paqes midis Arabisë Saudite dhe Izraelit

dukej se ishte afër, por "ajo që do të ndodhë gjatë ditëve në vijim, mund ta vërë atë në dyshim". "Ndoshta ky është qëllimi i Hamasit", shkroi mediumi britanik. Sipas tij, ky nuk është raund i zakonshëm i dhunës - "është shumë më serioze se kaq" dhe "inkursioni tokësor nuk përjashtohet". "Përgjigja e Izraelit ndaj sulmeve ka të ngjarë të jetë e një shkalle të tillë që do t'i frenojë përpjekjet e



ShBA-së për normalizimin saudito-izraelit, nëse jo t'i silurojë ato krejtësisht", shkroi në platformën "X", Amberin Zaman, analiste në "Al-Monitor", një ueb-faqe që mbulon Lindjen e Mesme, me bazë në Uashington.

Ushtria izraelite urdhëroi një përforsim masiv të trupave, ndërsa tubime për të shprehur mbështetje për Hamasin u mbajtën në të gjithë Lindjen e Mesme.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, tha se Shtetet e Bashkuara do të dërgojnë anije dhe avionë ushtarakë më pranë Izraelit në Mesdheun Lindor, në një demonstrim mbështetjeje për të, pas sulmit të Hamasit. Ai tha se ShBA-ja do të ofrojë edhe municione për Izraelin, ndërsa do t'i shtojë avionët luftarakë në rajon.

Cila është historia e konfliktit të Izraelit me Hamasin?

Izraeli ka një histori të gjatë armiqësie me Hamasin. Ai luftoi me të në Gazë katër herë dhe kreu shumë operacione të tjera, duke shkaktuar qindra viktima palestineze.

Militantët e Hamasit lëshuan mijëra raketa kundër Izraelit, duke vrarë qindra izraelitë. Izraeli e akuzon Hamasin për rrëmbimin e qytetarëve izraelitë dhe organizimin e protestave që kërcënojnë kufijtë e tij.

Hamasi dhe mbështetësit e tij, në anën tjetër, e akuzojnë Izraelin për shtypjen e palestinezëve dhe shkeljen e të drejtave të tyre.

Ai udhëheq Rripin e Gazës që nga viti 2007.

Hamasi në tërësi - ose në disa raste krahu i tij ushtarak - cilësohet si grup terrorist nga Izraeli, Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Britania e Madhe, si dhe nga fuqi të tjera.

Një tjetër skandal në Gjykatën Speciale

Emmersoni thotë se dëshmitari i radhës ka tentuar të negociojë me ZPS-në një pako përfitimi për të në këmbim të dëshmisë

Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka paraqitur një tjetër dëshmi që duket se përbën skandalin e radhës të Gjykatës Speciale në Hagë në gjyqin kundër krerëve të UÇK-së. Ai ka thënë se në shënimet përgatitore të dëshmitarit të radhës, dëshmitari tenton të negociojë me Prokurorinë një pako përfitimi për të në këmbim të dëshmisë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

HAGË, 9 TETOR - Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka ngritur të hënën një rast në Gjykatën Speciale, i cili përbën skandalin e radhës të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Emmersoni ka thënë se në shënimet përgatitore për dëshmitarin e radhës është vërejtur se ai ka tentuar të negociojë me prokurorinë një pako përfitimi për të në këmbim të dëshmisë.

Po ashtu, Emmersoni ka thënë se vërehet se aty dallohet një zyrtar i prokurorisë teksa i sugjeron dëshmitarit mundësi përfitimi në këmbim të dëshmisë. "Një dëshmitar i cili do të dëshmojë nesër apo kur e ka të planifikuar, nuk e di nëse keni pasur mundësi

ta shihni shënimin përgatitor apo korrigjues të tij. Ju lutem ta shihni shënimin përgatitor numër 2. Në këtë shënim përgatitor është një përshkrim që është bërë një përpjekje nga dëshmitari që të negociojë diçka me Prokurorinë përpara se të japë dëshminë. Është paragrafi 1 dhe 12. Diskutohet diçka lidhur me atë që është premtuar në të shkuarën dhe çfarë nuk është premtuar. Ka një kontradiktë të qartë mes asaj që është premtuar, dhe z. Pache ka një kontradiktë mes asaj që ai thotë se është pretenduar dhe asaj që pretendon Pache", ka deklaruar Emmerson.

Sipas avokatit, dëshmitari ka dashur të përfitojë diçka në këmbim të dëshmisë. "Kemi një situatë këtu. Dëshmitari ka shprehur dëshirën që të negociojë një përfitim apo pako të caktuar



dhe nuk e di nëse ju jeni të njohur me juridiksionin e Shteteve të Bashkuara dhe të Mbretërisë së Bashkuar, por këtu ngrihen pikëpyetje sa i takon sjelljes së përfaqësuesve të Prokurorisë, i cili në një farë mënyre i sugjeron dëshmitarit diçka në këmbim të të qenit dëshmitar i mundshëm, dhe në Mbretërinë e Bashkuar apo në ShBA kjo është e papranueshme, kur avokati i bën

një premtim dëshmitarit dhe vetë dëshmitari thotë se më ka premtuar diçka, e përfaqësuesi i Prokurorisë i thotë se i ka premtuar diçka tjetër. Ju kërkoj t'i shihni 17 paragrafët e parë për këtë shënim përgatitor, të shqyrtohet çfarë është ky premtim dhe çfarë pasoja ka kjo. Sepse kjo do të jetë një nga pjesët kryesore të kundërpvetjeve për këtë dëshmitar", ka thënë

Emmerson.

Në seancën e së hënës në Speciale ka dëshmuar reporter i mediumit serb, "Tanjug", Nebojsa Radosheviq, i cili pretendoi se është arrestuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës gjatë luftës. Ky dëshmitar ka pranuar një fakt të çuditshëm. Ai ka thënë se kur u mor në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar aty ishte edhe një prokuror serb.

Haliti në Asamblenë e NATO-s: U dënua vrasja e policit dhe plagosja e ushtarëve të KFOR-it

Prishtinë, 9 tetor - Delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga deputeti i PDK-së, Xhavit Haliti, është duke marrë pjesë në sesionin e 69 të vjetorit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

Fokusi kryesor i këtij takimi ka qenë situata në Ukrainë dhe gjendja në Kosovë, duke përfshirë vrasjen e policit Afrim Bunjaku dhe plagosjen e ushtarëve të KFOR-it.

Haliti ka thënë se mesazhi ishte se NATO-ja do të vazhdojë të jetë neutrale, në përputhje me kompetencat që rrjedhin nga Rezoluta 1244, ndërsa ndërmjetësi kryesor do të vazhdojë të jetë BE-ja.

Kurse ish-ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, tashmë kryetare e delegacionit shqiptar në AP të NATO-s, Mimi Kodheli, ka shprehur shqetësimin e Shqipërisë për situatën në veri,

me theks të veçantë për vrasjen e policit të Kosovës dhe plagosjen e KFOR-it. Të njëjtën çështje e ka ngritur edhe delegacioni i Kroacisë në AP të NATO-s. Kjo gjë është dënua.

Shqetësimi është shprehur edhe për aktet terroriste kundër Izraelit dhe u tregua një solidaritet gjithëpërfshirës me popullin izraelit.

Pas diskutimeve në komisione, në seancën e së hënës folës kryesorë ishin: Kryetari i AP-së së NATO-s, kryetari i Parlamentit të Danimarkës, kryeministri i Danimarkës, presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky (iu drejtua të pranishmëve përmes video-konferencës). Njëjtë pjesëmarrësve u është drejtuar edhe kryetari i Parlamentit të Ukrainës, ndërsa folësi i fundit në seancë ka qenë zëvendëssekretari i përgjithshëm i NATO-s.





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË “ORGANIZATË TERRORISTE”? (3)

Manipulimi serb me listat e të vrarëve, të rrëmbyerve dhe të zhdukurve gjatë luftës në Kosovë

-Adem Demaçi: “Vrasja e civilëve ka shërbyer për t’ia prezantuar botës se shqiptarët vrasin njerëz të pafajshëm, të cilët, në asnjë mënyrë, nuk janë të përfshirë në operatione luftarake”.

-Jakup Krasniqi: “Që nga themelimi i saj UÇK-ja është distancuar nga aktet e dhunshme ndaj civilëve, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për shqiptarë, serbë apo të tjerë që jetojnë në Kosovë”.

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive për “Epokën e re”, në vazhdimin e pjesës së tretë, ka folur për manipulimin e Serbisë me listat e të vrarëve, të rrëmbyerve dhe të zhdukurve gjatë luftës në Kosovë. Ai ka theksuar se pas përfundimit të luftës, propaganda zyrtare serbe u përpoq ta hiqte përgjegjësinë shtetërore për krimet më të përbindshme që ishin kryer gjatë zbatimit të politikës së gjenocidit në Kosovë

PRISHTINË, 9 TETOR - “Epoka e re”: A mund të ilustronhet me emra konkretë kjo formë e manipulimit me listat e të vrarëve? **Bardhyl Mahmuti:** Në mars të vitit 2000, gjatë kohës kur ende pushteti ishte në duar të Sllobodan Millosheviqit, Qeveria e Jugosllavisë (Serbi - Mali i Zi) botoi në gjuhën angleze të ashtuquajturin “Libër i bardhë”, i titulluar “Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija” (Aktet terroriste të grupeve terroriste shqiptare në Kosovë dhe Dukagjin). Në funksion të manipulimit të institucioneve politike dhe ato të drejtësisë ndërkombëtare, të cilave ua kishin shpërndarë librin falas, u publikuan listat e ushtarëve, të policëve dhe të civilëve të të gjitha përkatësive etnike të vrarë gjatë luftës në Kosovë, vrasja e të cilëve i

vishej UÇK-së. Pas rrëzimit të Sllobodan Millosheviqit nga pushteti, qeveria e re “demokratike” e këtij shteti, në muajin nëntor të vitit 2001, botoi variantin e ri të “librit të bardhë”, të titulluar “Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji-Ubijena, oteta i nestala lica, januar 1998 - novembar 2001” (Viktimat e terrorizmit shqiptar në Kosovë dhe Metohi- Personat e vrarë, të rrëmbyer dhe të zhdukur, janar 1998-nëntor 2001). Duke bërë një analizë krahasuese të listave zyrtare të publikuara në këto libra kam nxjerrë në shesh manipulimet e shumta që janë bërë në funksion të fshehjes të së vërtetës. Kështu, në botimin e vitit 2000, në numrin rendor 5 të listës së punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vrarë nga

UÇK-ja, figuron polici Milan Jovanović (Jovanović). Në botimin e vitit 2001, i njëjti person u transferua në listën e viktimave civile “të rrëmbyer ose të zhdukur pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”! Madje, sipas kësaj liste, Milan Jovanović ishte rrëmbyer dy herë! Në numrin rendor 334 ai u rrëmbye më 18 qershor 1999 në fshatin Babush të Ferizajt, ndërsa në numrin rendor 335 rrëmbimi ka ndodhur më 22 qershor 1999 në Ferizaj! Në botimin e vitit 2000, në numrin rendor 48 të listës së punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vrarë nga UÇK-ja, figuron polici Srečko Majanović (Srečko Majanović). Në sqarimet që jepen rreth vrasjes së tij saktësohet se ky polic ishte plagosur më 1 gusht 1998, pastaj ishte transferuar në Akademinë



Spitalore Ushtarake në Beograd, ku kishte vdekur më 4 gusht 1998. Në botimin e vitit 2001 Srečko Majanović u transferua në numrin rendor 44 të listës së viktimave civile “të rrëmbyer ose të zhdukur pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”! Në botimin e vitit 2000, në numrin rendor 81 të listës së punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vrarë nga UÇK-ja, figuron polici Zoran Vasilević (Vasilević). Në botimin e vitit 2001 Zoran Vasilević u transferua në numrin rendor 84 të listës së viktimave civile “të rrëmbyer ose të zhdukur pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”! Në botimin e vitit 2000, në numrin rendor 233 të listës së punëtorëve

të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vrarë nga UÇK-ja, figuron polici Vasilije Stanković (Stanković). Në botimin e vitit 2001 Vasilije Stanković u transferua në numrin rendor 562 të listës së viktimave civile “të rrëmbyer ose të zhdukur pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”! Në botimin e vitit 2000, në numrin rendor 234 të listës së punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vrarë nga UÇK-ja, figuron polici Predrag Mitić (Mitić). Në botimin e vitit 2001 Predrag Mitić u transferua në numrin rendor 353 të listës së viktimave civile “të rrëmbyer ose të zhdukur pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”! Në botimin e vitit 2000, në numrin

rendor 235 të listës së punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vrarë nga UÇK-ja, figuron polici Djordje Ristić (Gjorgje Ristić). Në botimin e vitit 2001 Djordje Ristić u transferua në numrin rendor 493 të listës së viktimave civile “të rrëmbyer ose të zhdukur pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”!

Në botimin e vitit 2000, në numrin rendor 269 të listës së punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vrarë nga UÇK-ja, figuron polici Srdjan Stojković (Sërgjan Stojković). Në botimin e vitit 2001 Srdjan Stojković u transferua në numrin rendor 872 të listës së viktimave civile “të rrëmbyer ose të zhdukur pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”!

Mund të vazhdojmë me fatin e policëve Sladjan Milosavljević, Predrag Milosavljević, Ljubiša Mitrović, Nebojsa Jefić, Dragan Stanković, Djordje Balošević, Duško Dolašević, Boban Matić dhe shumë policëve të tjerë që ishin hequr nga lista e punonjësve të vrarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe që ishin “transferuar” në listën e “civilëve të vrarë apo të zhdukur nga UÇK-ja”. Por do të kufizohemi vetëm edhe në një rast: Në numrin rendor 46, të botimit të vitit 2001, në listën e viktimave civile “të rrëmbyer ose të zhdukur pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”, përmendet një i vrarë, për të cilin Shërbimi Sekret i Serbisë nuk e di as nga cili vend është, as moshën e tij dhe as emrin! Jepet vetëm mbiemri i të vërtetë: Bukumirović (Bukumiroviq)! Në sqarimin shtesë për rrethanat në të cilat ka humbur jetën ky person thuhet se “është vrarë së bashku me policin Milorad Bulatović”.

Çdo lexues i vëmendshëm do të verifikonte nëse jepeshin të dhëna plotësuese për personin Bukumirović në listën e punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vrarë nga UÇK-ja kur sqarohet vrasja e policit Milorad Bulatović. Por, më kot! Nuk ka asnjë të dhënë plotësuese, sepse Milorad Bulatović nuk figuron në listën e publikuar të policëve të vrarë. Edhe ky polic i vrarë është transferuar në listën e “civilëve të vrarë nga UÇK-ja”!

Sa i përket këtij aspekti nuk duhet të harrojmë se “transferimi” i emrave nga lista e punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vrarë nga UÇK-ja, në listën e “civilëve të vrarë nga UÇK-ja” përbën vetëm një pjesë të realitetit të këtyre listave. Askush prej nesh nuk mund ta dijë numrin e saktë të policëve që erdhën nga qytetet e Serbisë për të luftuar në Kosovë, të cilët u vranë në luftë me UÇK-në. Por është e sigurt se asnjëri prej tyre nuk figuron në listën e policëve të vrarë!

“Epoka e re”: Për aq sa jemi në dijeni, e njëjta gjë ndodhi edhe me listën e ushtarëve të Armatës Jugosllave të vrarë para ndërhyrjes ushtarake të NATO-s.

Bardhyl Mahmuti: Po! Keni plotësisht të drejtë! Në botimin e vitit 2001 jepet identiteti i 341 ushtarëve të vrarë më tepër sesa

numri i publikuar në botimin e vitit 2000 i ushtarëve të vrarë nga UÇK-ja përpara ndërhyrjes ushtarake të NATO-s. Flasim për shifra zyrtare! Imagino për realitetin!

“Epoka e re”: Përgjegjja juaj lë të nënkuptohet që manipulimi me lista ka qenë edhe më i madh. Nëse e kemi kuptuar drejt supozimin tuaj, atëherë në çka mbështeteni?

Bardhyl Mahmuti: Pas përfundimit të luftës, propaganda zyrtare serbe u përpoq ta hiqte përgjegjësinë shtetërore për krimet më të përbindshme që ishin kryer gjatë zbatimit të politikës së gjenocidit në Kosovë. Për këtë qëllim ua hodhën fajin strukturave të armatosura të njohura me emrat “Skorpion”, “Šakali”, “Tigrovi”, “Žute ose”, “Knindže” etj., duke i prezantuar si “grupe vullnetare paramilitare, jashtë kontrollit të pushtetit qendror”!

Çështja e “paramilitarëve” është trajtuar më hollësisht në një shkrim tjetër. Në kontekst të manipulimit me listat e të vrarëve në Kosovë po tërheqim vërejtjen në faktin se në asnjë listë zyrtare nuk figuron kategoria e “paramilitarëve të vrarë, të rrëmbyer apo të zhdukur në Kosovë”.

Zyrtarisht pjesëtarët e këtyre strukturave të armatosura nuk konsideroheshin pjesë të forcave ushtarake ose policore serbe. Për çdo person serioz që ka krahasuar listat e publikuara në botimet e ndryshme zyrtare serbe dhe ka konstatuar zhvendosjen e policëve të vrarë nga lista e punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në listën e civilëve të vrarë nuk ka asnjë dyshim se të gjithë pjesëtarët e grupeve të lartpërmendura janë renditur në listën e “civilëve të vrarë nga UÇK-ja”.

“Epoka e re”: Me sa kemi njohuri për manipulimin me listat e sajuara nga Shërbimi Sekret i Serbisë për të vrarët gjatë luftës në Kosovë, rasti i personit me mbiemër “Bukumirović” nuk është rasti i vetëm në listat e sajuara nga Shërbimi Sekret i Serbisë për të vrarët gjatë luftës në Kosovë ku nuk jepen të dhëna të plota të identitetit të personit të vrarë.

Bardhyl Mahmuti: E saktë! E njëjta gjë vlen edhe për personin me mbiemër Vujinović, numër rendor 73. Emri nuk i dihet. Vučić, numër rendor 92. Emri nuk i dihet! Zlatković, numër rendor 196, gruaja e Radomirit që figuron në numrin 195, pa emra! Zlatković, numër rendor 197, vajza me të



meta e Radomirit, pa emër! Jovanović, numër rendor 248, pa emër! Kizić, numër rendor 264, pa emër! Marušić, 321, pa emër! Pešić, numër rendor 445, pa emër! Rajčić, numër rendor 479, pa emër! Stojanović, numër rendor 601, pa emër! Čučkić, numër rendor 680, pa emër! Dhe shumë persona tjerë pa emra. Pastaj kemi Boško, numër rendor 695, pa mbiemër! Živko, numër rendor 696, pa mbiemër! Zoran, numër rendor 697, pa mbiemër! Ivica, numër rendor 698, emri i babës Velimir, por asnjëri nuk i dihet mbiemri! Ilija, numër rendor 699, pa mbiemër! Ružica, numër rendor 700, pa mbiemër! Srba, numër rendor 701, pa mbiemër! Stoja, numër rendor 702, pa mbiemër!... Në numrat rendorë 703-709 janë shtatë persona të cilëve nuk u publikohet as emri e as mbiemri! Kësaj liste iu shtuan edhe 72 persona të paidentifikuar, por e dinë se janë “civilë serbë të varë nga UÇK-ja”!

“Epoka e re”: Përveç shembujve të transferimit të pjesëtarëve të vrarë të forcave të armatosura serbe në “listën e civilëve të vrarë, të rrëmbyer apo të zhdukur nga UÇK-ja”, çka do të veçonit për lexuesit?

Bardhyl Mahmuti: Rasti i vrasjes së gjashtë të rinjve të përkatësisë serbe dhe malazeze në kafenenë “Panda”, në qytetin e Pejës, më 14 dhjetor 1998, është domethënë. Mbi 100 shqiptarë u torturuan mizorisht me qëllim që t’i detyronin të pranonin se gjoja kishin kryer këtë krim dhe në fund hetuesit serbë kishin arritur të nxirrnin me darë nga Behar Bajri (18 vjeç), Vllaznim Përgjegjaj (19 vjeç), Gazmend Bajrami (20 vjeç), Xhevdet Bajrami (21 vjeç), Agron Kollçaku (26 vjeç) dhe Beqir Loxhaj (27 vjeç) pohimet se përpos vrasjes

së të rinjve serbë dhe malazezë në këtë kafene, “si pjesëtarë të UÇK-së ata kishin krijuar një grup të veçantë të emëruar “Bombashi” dhe kishin vrarë shumë policë në fshatrat Prilep dhe Carrabreg të komunës së Deçanit”.

“Epoka e re”: Vrasja në kafenenë “Panda” pati një jehonë shumë të madhe si në rrafshin e brendshëm, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Bardhyl Mahmuti: Është e vërtetë se ky akt terrorist gjeti një hapësirë të konsiderueshme në mediet ndërkombëtare, ndërkaq William Walkeri në emër të 54 shteteve të OSBE-së dënoi me ashpërsi këtë krim.

Të bindur se një akt i tillë kriminal nuk mund të imagjinohej as si akt i izoluar nga ndonjë shqiptar, në të gjitha konferencat me gazetarë apo në kontaktet diplomatike që patën në atë kohë, ne e kemi përgjeshtruar propagandën serbe. Po sjell për lexuesit vetëm disa shembuj që ilustrjnë në mënyrë të përkryer qëndrimet tona rreth vrasjes së civilëve në përgjithësi, apo të rastit konkret në veçanti. Në konferencat me gazetarë të mbajtura në Zyrën e Përfaqësuesit të Përgjithshëm Politik të UÇK-së në Prishtinë, më 15 dhjetor dhe më 22 dhjetor 1998, Adem Demaçi, dënoi vrasjen e civilëve pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Të njëjtin qëndrim e përsëriti në Deklaratën Politike nr. 21, të datës 17 dhjetor 1998, të lëshuar në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në këtë kontekst e shoh të rëndësishme të citoj një pjesë të kësaj deklaratë: “Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shumë herë deri më tani është distancuar nga çdo formë e dhunës që është ushtruar mbi qytetarët e pambrojtur e të paarmatosur, pa marrë parasysh



se cilës etni i kanë takuar viktimat. Ushtria çlirimtare e Kosovës nuk është kryese e as nxitëse e vrasjes mizore të të rinjve serbë në një kafene të Pejës. Ne jemi të bindur se ajo vrasje është vepër e policisë sekrete serbe, polici kjo e përgatitur për akte të tilla mizore, e që i ka kryer edhe herëve të tjera mbi shqiptarët e qytetarët e tjerë të Kosovës. Edhe vrasja ditë më parë në Gillogoc të Drenicës, edhe pse njëra nga viktimat ishte pjesëtar i policisë serbe, është kryer nga e njëjta derë, për t’i humbur gjurmët e krimit, pasi polici Qorri ndoshta një ditë do të mund të dëshmonte për krimet serbe të kryera në Drenicë.

Qëllimi i këtyre vrasjeve, sidomos i të parës, është t’i acarojë edhe më marrëdhëniet shqiptaro-serbe, për t’i ngjallur ndjenjat shoviniste, për ta ringjallur moralin e humbur në radhët e veta dhe për t’u hedhur hi syve të diplomacisë botërore, por edhe për ta arsyetuar politikën e tyre të gjenocidit e të terrorit para popullit të vet dhe opinionit të gjerë ndërkombëtar”.

Sa iu përket takimeve diplomatike, po përmend takimin që zhvilloi në Dragobil të Malishevës zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, me Lawrence Rosin (drejtor i Drejtorisë për Evropën Juglindore në Departamentin e Shtetit Amerikan). Përzgjodha këtë takim për të vetmen arsye se qëndrimet e Adem Demaçit dhe të Jakup Krasniqit për vrasjen në kafenenë “Panda” në Pejë, dhe për vrasjen e nënkryetarit të komunës së Fushë-Kosovës, Zvonko Bojaniq, gjetën hapësirë mediatike edhe në gazetën beogradase “Vreme”.

Kështu edhe opinioni publik i Serbisë pati mundësi të informohej për mohimin kategorik të propagandës shtetërore serbe që përpiqej t’i vishte UÇK-së krimet që nuk i kishte bërë dhe të njëjhe me qëndrimet e përfaqësuesve politikë të UÇK-së. Lidhur me vrasjen e nënkryetarit të komunës së Fushë-Kosovës gazeta “Vreme” citon thënie të Adem Demaçit: “Bojaniq fliste gjuhën shqipe në mënyrë të përkryer dhe shqiptarëve u kishte bërë vetëm të mira. Nuk ka asnjë shqiptar që flet keq për të. Këto fakte na shtojnë të jemi 100 % të sigurt se ai nuk ka humbur jetën nga dora e shqiptarit. Sipas të gjitha gjasave, puna e Bojaniqit për t’u afruar me shqiptarët ka qenë shkak i eliminimit të tij. Në këtë mënyrë do t’u pamundësohej të tjerëve të punojnë në përafrimin e shqiptarëve, serbëve dhe malazezëve. Këto vrasje u kanë shërbyer për t’ua prezantuar botës se shqiptarët vrasin njerëz të pafajshëm, të cilët në asnjë mënyrë nuk janë të përfshirë në operacione luftarake”. Nderkaq pas takimit në Dragobil të Malishevës me Lawrence Rosin (drejtor i Drejtorisë për Evropën Juglindore në Departamentin e Shtetit Amerikan), në cilësinë e zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi deklaroi: “Që nga fillimi UÇK-ja është distancuar nga aktet e dhunshme ndaj civilëve, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për shqiptarë, serbë apo të tjerë që jetojnë në Kosovë”.

(Muhamet MAVRAJ / Vizion)

Shtyhet gjykimi i ministres Hajdari, mbrojtja kërkon që ekspertët të dëshmojnë për aksidentin

PRISHTINË, 9 TETOR - Seanca gjyqësore ndaj ministres së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, për aksidentin ku kishte goditur me veturë një fëmijë, është shtyrë për 11 tetor. Pas përfundimit të kësaj seance në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e pandehura ministrja Hajdari ka thënë se nuk ka ndonjë vendim nga seanca e sotme gjyqësore. "Nuk ka vendim sot. Punë të

mbarë juve", ka theksuar ajo shkurt për "KosovaPress". Ndërkaq avokati i ministres, Shemdi Bunjaku, ka thënë se në seancë deklaruan për superekspertizën, me ç'rast ka shtuar se i propozuan gjykatës që për këtë të jetë i pranishëm edhe një grup i ekspertëve. Bunjaku ka theksuar se seanca e sotme është ndërprerë dhe është caktuar për ditën e mërkurë në orën

13:15. Ai ka arsyetuar kërkesën për mbajtjen e seancës pa praninë e medieve. Kundër kësaj kërkesë ishte avokati i palës së dëmtuar, Florim Shefqeti. Bunjaku ka thënë se kjo është bërë për t'u respektuar Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve. Sa i përket superekspertizës, Bunjaku tha se në momentin e aksidentit Hajdari ka qenë duke e respektuar Ligjin e Komunikacionit.



BE-ja: Serbia të bashkëpunojë pa kushte për hetimin e sulmit në Banjskë

PRISHTINË, 9 TETOR - Bashkimi Evropian pret nga Serbia jo vetëm bashkëpunim të plotë, por edhe pa kushte gjatë hetimeve për zbardhjen e plotë të sulmeve që ndodhën në Banjskë, në veri të Kosovës më 24 shtator, të cilat BE-ja i quajti terroriste. Në këtë rast, askush nuk duhet të fshihet prapa qëndrimeve rreth statusit si pretekst. Këtë e ka thënë të hënën, në një konferencë me gazetarë në Bruksel, zëdhënësi i BE-së për çështje të jashtme dhe siguri, Peter Stano, duke iu përgjigjur pyetjeve se me kë duhet të bashkëpunojë Serbia në hetime pasi Beogradi thotë se nuk e njeh Kosovën. Beogradi, po ashtu, ka deklaruar se nuk do ta ekstradojë në Kosovë Milan Radoiçiqin, i cili e ka marrë përgjegjësinë për sulmin në Banjskë.

Rezultati i hetimeve po pritet në BE edhe për të sqaruar nëse do të ketë masa ndëshkuese ndaj Serbisë. Një numër i madh shtetesh kanë kërkuar të vendosen masa ndaj Serbisë, por Komisioni Evropian dhe disa vende anëtare po hezitojnë me arsyetimin se "duhet pritur përfundimin e hetimeve për të parë se a ka pasur lidhje Serbia me këtë akt". "Pritjet tona nga Serbia janë jo vetëm që të ketë nga ajo bashkëpunim të plotë, por të ketë bashkëpunim pa kushte. Nëse ka vullnet, ka edhe rrugë dhe askush nuk duhet të fshihet prapa formaliteteve si njohja e palës tjetër apo mosnjohja. Ka shumë rrugë se si mund t'i shkëmbeni evidencat, si



mund të bashkëpunoni dhe si mund të kontribuoni plotësisht në hetime", ka thënë Stano. Ai nuk ka dashur të flasë konkretisht se a është duke luajtur BE-ja rolin e lehtësuesit në hetime pasi autoritetet e Serbisë dhe të Kosovës nuk kanë kontakte direkte. Stano nuk u është përgjigjur as pyetjeve se a ka BE-ja informata nga Beogradi nëse është akuzuar dikush tjetër për këtë akt përveç

Radoiçiqit, që veçse e ka marrë përgjegjësinë për sulmin. Ai ka përsëritur disa herë se "kjo është një çështje shumë serioze dhe do të ketë pasoja pasi të kryhen hetimet". "Ajo që ndodhi më 24 shtator është diçka aq serioze saqë duhet të sqarohet në tërësi, sepse do të ketë pasoja. Nuk dua të hyj në komente individuale në këtë fazë të hetimeve, sa njerëz ishin përfshirë e sa jo. Qëndrimi i BE-së është shumë

i qartë. Është shprehur para palëve disa herë e ai është se presim bashkëpunim nga Serbia dhe nga cilado palë që mund të kontribuojë që sa më shpejt të sqarohet ajo që ndodhi, pse ndodhi, kush mori pjesë dhe kush e orkestroi atë. Dhe, në bazë të kësaj, BE-ja do të vendosë se cilët do të jenë hapat e ardhshëm ndaj Serbisë, ndaj Kosovës, ndaj dialogut dhe ndaj rajonit", ka thënë ai.

Zëdhënësi i BE-së ka thënë se edhe në takimet e shumta që janë zhvilluar në fund të javës së shkuar në marginat e samitit në Granada të Spanjës, përfshirë takimet që përfaqësuesi i lartë, Josep Borrell, ka pasur me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është përsëritur thirrja për hetimin e sulmit, por edhe për kthim në dialog dhe për uljen e tensioneve.

Kuvendi, komision hetimor për rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje

PRISHTINË, 9 TETOR - Është konstituuar të hënën Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje. Ai ka qëllim t'i hetojë rastet e gjykuara dhe në gjykim të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Kryesuesi i këtij komisioni, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Alban Bajrami, ka thënë se pas hetimeve, komisioni do të dalë me një rekomandim për

institucionet sesi duhen trajtuar rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. "Dhuna ndaj grave është një ndër format më të përhapura të dhunës dhe shkeljeve të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut në Republikën e Kosovës. Të gjithë ne kemi qenë dëshmitarë dhe kemi parë raste monstruoze që kanë marrë vëmendjen tonë por, për fat të keq, vetëm kur ato kanë përfunduar me fatalitet, ne kemi mësuar për dhunën

e ushtruar ndaj këtyre viktimave dhe për shkeljet dhe lëshimet e bëra nga institucionet përkatëse dhe përgjegjëse për parandalimin, menaxhimin dhe dënimin e dhunuesve", ka deklaruar ai. Ky komision është themeluar në muajin qershor të këtij viti me nënshkrimin e 42 deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Në konstituimin e këtij komisioni sot munguan deputetët nga radhët e opozitës.



Universiteti i Prishtinës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Drake në Iowa

PRISHTINË, 9 TETOR - Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti Drake në Iowa, Shtetet e Bashkuara, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për njohjen e vlerës thelbësore të promovimit të bashkëpunimit edukativ, kulturor dhe kërkimor midis universiteteve.

Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje është ta bëjë bashkëpunimin akademik më të lehtë në fusha të ndryshme, si reformimi i kurrikulës, projektet kërkimore, trajnimi, zgjerimi



institucional dhe fusha të tjera me interes të përbashkët.

Të dy universitetet do të mund të marrin pjesë në një gamë të gjerë aktivitete bashkëpunuese. Kjo përfshin shkëmbimin e studentëve, stafit akademik dhe akademikëve në të gjitha nivelet e studimit (bachelor, master dhe doktoraturë), pritjen e anëtarëve të fakultetit për vizita të shkurtra, punën e përbashkët në projekte kërkimore, pjesëmarrjen e përbashkët në

seminare dhe konferenca dhe përfshirjen në aktivitete të tjera. Këtë marrëveshje e kanë nënshkruar rektori Qerim Qerimi i Universitetit të Prishtinës dhe presidenti Marty Martin i Universitetit Drake. Përkushtimi i vazhdueshëm i Universitetit të Prishtinës për rritjen e rritjes së tij akademik në mbarë botën dhe zhvillimin e bashkëpunimit me vendet e tjera, zyrtarizimi i këtij bashkëpunimi paraqet një pikë të rëndësishme në këtë aspekt.

Osmani vlerëson angazhimin e shtuar të NATO-s për rritjen e sigurisë në Kosovë

PRISHTINË, 9 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në një takim admiralin Stuart B. Munsch, komandant i Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate të NATO-s në Napoli. Ajo e falënderoi atë për mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s për ruajtjen e stabilitetit dhe paqes në Kosovë dhe rajon, pas aktit të agresionit dhe sulmit terrorist të Serbisë ndaj Kosovës më 24 shtator.

Presidentja Osmani theksoi nevojën e marrjes së masave konkrete kundër Serbisë pas aktit të agresionit dhe sulmit terrorist nga grupet paramilitare dhe kriminale të udhëhequra në

teren nga Milan Radoičiq dhe politikisht nga Aleksandër Vuçiq. Ajo nënvizoi se Serbia duhet t'i tërheqë trupat ushtarake nga kufiri me Kosovën pasi që ato përbëjnë rrezik për paqen dhe stabilitetin në rajon.

Ajo vlerësoi angazhimin e shtuar të KFOR-it dhe NATO-s për rritjen e sigurisë përgjatë kufirit Kosovë - Serbi dhe e konsideroi atë veprim të nevojshëm për ta parandaluar përsëritjen e aktit të ndodhur më 24 shtator.

Në takim u theksua rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë në mes të institucioneve të sigurisë së Kosovës dhe atyre të NATO-s për ballafaqimin me sfidat e sigurisë në vend dhe rajon.



Rikonstrukti i gjirit pa pagesë për herë të parë në QKUK

PRISHTINË, 9 TETOR - Klinika e Kirurgjisë Plastike, në bashkëpunim me Shoqatën e Kirurgëve Plastik Rekonstruktivë, për herë të parë janë duke ofruar rikonstruktimin e gjirit pa pagesë për të gjitha gratë të cilat kanë kaluar fazën e kancerit të gjirit. E gjithë kjo po bëhet në muajin e ndërgjegjësimit për gratë e prekura me kancer të gjirit. Motoja e kësaj iniciative është "T'ia kthejmë buzëqeshjen gruas".

Drejtori i Shoqatës së Kirurgëve Plastikë, Ylber Zejnullahu, ka thënë për "KosovaPress" se përmes donacioneve të mbledhura këtë vit ofrohet rikonstruktimi i gjirit për gratë e



prekura me kancer të gjirit. Ai ka thënë se një trajtim i tillë

sikur në shtetet e tjera edhe në Kosovë ka qenë i nevojshëm. "Ne

kemi marrë shkas duke parë nevojat e grave, se kanë nevojë

për rekonstrukcion mbasi e kanë kaluar kancerin. Aspekti psikologjik është shumë i rënduar dhe kemi dashur të krijojmë si shtetet e tjera një fond të veçantë përmes QKUK-së dhe donacioneve nga jashtë. Kemi siguruar një sasi të disa balonave të cilët e rritin sipërfaqen e lëkurës, sepse atyre u mungon një gjoks, rrallë edhe dytë", ka thënë Zejnullahu.

Zejnullahu ka treguar se ky operacion është shumë i kushtueshëm nëse bëhet në klinika private. Ai u ka bërë thirrje të gjitha grave që të interesohen për këtë model të përmbushjes së gjirit sepse e gjitha procedura është falas.

Përforcohet KFOR-i edhe me 200 ushtarë britanikë në Kosovë

PRISHTINË, 9 TETOR - Ka arritur kontingjenti prej 200 ushtarëve britanikë në Kosovë. Ardhja e ushtarëve britanikë si përforsim i KFOR-it ka ardhur si rezultat i sulmit terrorist që ndodhi më 24 shtator. Kjo është bërë me dije edhe nga Shtabi Suprem i Fuqive Aleate në Evropë përmes një postimi në rrjetin social "X". "Dyqind ushtarë të Ushtrisë Britanike po mbërrijnë në Kosovë për ta

përforsuar misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë", thuhet në njoftim.

Misioni paqeruajtës i Forcave të NATO-s në Kosovë - KFOR në njoftimin zyrtar ka njoftuar se dislokimi vjen pas sulmit të dhunshëm ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator dhe rritjes së tensioneve në rajon. "Dislokimi bazohet në një kërkesë të Komandantit Suprem të Aleatëve të NATO-s

për Evropë dhe u miratua nga Aleatët në Këshillin e Atlantikut të Veriut. NATO ka udhëhequr një operacion paqeruajtës në Kosovë që nga viti 1999 në përputhje me mandatin e saj, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. KFOR-i aktualisht përbëhet nga mbi 4 500 trupa nga 27 aleatë dhe partnerë të NATO-s", thuhet në njoftim.



Çmimet e naftës rriten pas sulmit të Hamasit ndaj Izraelit

PRISHTINË, 9 TETOR - Çmimet e naftës janë rritur për shkak të situatës në Izrael dhe Gazës. Nafta e papërpunuar Brent, standardi ndërkombëtar, u rrit 2.50 dollarë për fuçi në 87.05 dollarë. Edhe çmimet në ShBA u rritën gjithashtu.

Izraeli dhe territoret palestineze nuk janë prodhues të naftës, por rajoni i Lindjes së Mesme përbën pothuajse një të tretën e furnizimit global.

Sulmi i Hamasit ndaj Izraelit ishte përshkallëzimi më i madh midis dy palëve për dekada, ku vendet perëndimore i dënuan këto sulme.

Një zëdhënës i Hamasit, grupi militant palestinez, i tha BBC-së se grupi kishte mbështetje të drejtpërdrejtë për lëvizjen nga Irani, një nga prodhuesit më të mëdhenj të naftës në botë.

Irani mohoi përfshirjen në sulm në një takim të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në Nju-Jork të dielën, raporto i "Reuters", por presidenti iranian Ebrahim Raisi ka shprehur mbështetjen për sulmin.

Analisti i energjisë Saul Kavoniç i tha BBC-së se çmimet globale të naftës janë rritur për shkak të përshkallëzimit më të gjerë të situatës, që mund të përhapet në



vendet e afërta të mëdha prodhuese të naftës si Irani dhe Arabia Saudite.

Të hënën në mëngjes çmimi i naftës së papërpunuar të

Teksasit Intermediate, pikë referimi në ShBA, u rrit 2,70 dollarë për fuçi në 85,50 dollarë.

"Nëse konflikti përfshin Iranin, i cili është akuzuar për

mbështetjen e sulmeve të Hamasit, deri në 3 për qind të furnizimit global të naftës, është në rrezik", shtoi Kavoniç.

Caroline Bain, kryeekonomiste e

mallrave në Capital Economics, i tha programit të BBC-së "Today" se Irani kishte rritur prodhimin e naftës gjatë këtij viti pavarësisht prej sanksioneve të ShBA-së.

Bain tha se Capital Economics priste që kërkesa për naftë ta tejkalojë ofertën në tre muajt e fundit të vitit dhe kjo duhet të mbështesë çmime më të larta.

Kavoniç tha se rreth një e pesta e furnizimit global do të mbahej peng nëse kalimi përmes Ngushticës së Hormuzit, një rrugë jetike e tregtisë së naftës, ndërpritet. Ngushtica e Hormuzit është vendimtare për eksportuesit kryesorë të naftës në rajonin e Gjirit, ekonomitë e të cilëve janë ndërtuar rreth prodhimit të naftës dhe gazit.

Pasiguria se si mund të zhvillohen ngjarjet në ditët në vijim mund t'i nxisë investimet në bonot e thesarit të ShBA-së dhe dollarin, të cilat investitorët tradicionalisht i blejnë në kohë krize, tha James Cheo nga banka HSBC.

Të hënën banka qendrore e Izraelit tha se do të shesë deri në 30 miliardë dollarë valutë të huaj në një përpjekje për t'i qetësuar tregjet dhe për ta mbështetur monedhën e vendit, shkelin, e cila ka rënë ndjeshëm.

ATK-ja u bënë thirrje personave që merren me aktivitete afariste ta paguajnë tatimin

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 TETOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ua ka rikujtuar të gjithë personave të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të obliguar të: regjistrohen, mbajnë dokumentacion, deklarojnë dhe t'i paguajnë saktë detyrimet tatimore.

Sipas ATK-së, bazuar në Planin Strategjik 2022-2026 dhe Planin e Trajtimit të Rreziqeve për vitin 2023, ky institucion ka hartuar planin e veprimit për ta përmirësuar përbushjen tatimore të personave të



tatueshëm të regjistruar për TVSh, përfshirë të gjithë faktorët me ndikim në kreditimin e TVSh-

së. Përmes këtij plani, ATK-ja do të kryejë aktivitete intensive me

qëllim të identifikimit të personave të cilët nuk deklarojnë saktë kreditimin e TVSh-së. "Administrata Tatimore e Kosovës u bënë thirrje të gjithë personave të tatueshëm që të përbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor, gjegjësisht të: Deklaroni dhe paguani saktë tatimin; Mbani dokumentacionin sipas Ligjit; Deklaroni furnizimet tuaja duke aplikuar saktë normën e TVSH-së; Zbritjen e TVSH-së ta bëni saktë sipas Ligjit të TVSH-së; Aplikoni ngarkesën e kundërt për TVSH, ashtu siç kërkohet me Ligj; etj. Administrata Tatimore e Kosovës, inkurajon të gjithë

personat fizikë afarist dhe personat juridikë t'u përgjigjen saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën, do të ndërmerren masat e përcaktuara me legjislacionin tatimor", ka njoftuar ATK-ja, duke theksuar se me kryerjen e detyrimeve tatimore personat të cilët merren me aktivitete afariste kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, shërbime më të mira shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie të qëndrueshme ekonomike dhe shoqërore.

Gubernurori i BQK-së po merr pjesë në takimet vjetore të FMN-së dhe BB-së

PRISHTINË, 9 TETOR - Një delegacion i lartë i Bankës Qendrore të Kosovës, i kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili, me pjesëmarrjen e kryetarit të Bordit, Bashkim Nurboja dhe ushtruesin e detyrës së drejtorit të Mbikëqyrjes Bankare, Blerim Terziqi, po merr pjesë në takimet vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) që po mbahen në Marakesh të Marokut.

Delegacioni i udhëhequr nga guvernatori Ismaili do të ketë takime me zyrtarë të lartë të FMN-së dhe BB-së, ku do të diskutohet mbi ecuritë ekonomike dhe financiare gjatë vitit 2023 si dhe pritjet për vitin 2024 e tutje.

Në këto takime guvernatori Ismaili do t'i paraqesë prioritetet e tij për sektorin financiar dhe do të kërkojë mbështetje të këtyre dy institucioneve për zbatimin e tyre. Këto prioritetet synojnë forcimin tutje të

kapaciteteve dhe sistemeve të BQK-së, si parakusht për një sektor të shëndoshë financiar dhe përkrahës ndaj sektorit privat dhe ekonomive familjare.

Gjatë qëndrimit të tij në Marakesh, guvernatori Ismaili do të nënshkruajë me Bankën Botërore marrëveshjen për anëtarësim të BQK-së në programin e Thesarit të Bankës Botërore, i quajtur "Reserve Advisory & Management Partnership" (RAMP).



“Muzikë, pastaj vetëm vdekje. Kështu shpëtova mes 260 kufomave”

Për Arik Nanin, festa e muzikës rave në shkretëtirë pak kilometra larg kufirit me Gazën, në ditën e fundit të festës hebreje të Sukkotit, duhej të ishte një mundësi për t'u argëtuar, shkëputur dhe festuar ditëlindjen e tij të njëzet e gjashtë, që bie këtë javë. “Pas asaj që ndodhi, mund të falënderoj Zotin që e arrij gjallë. Është si të lindësh për herë të dytë”, thotë Nani duke folur për italianen La Repubblica. I organizuar pranë Kibbutzit Re'im, festivali muzikor “psy-trance” premtoi mbi dymbëdhjetë orë muzikë me DJ nga e gjithë bota, nga Japonia në Francë, një prodhim ndërkombëtar (brazilianët e Universo Paralelo) në partneritet me grupin vendas Supernova. Në vend të kësaj, ai u bë skena e masakrës, me terroristët që erdhën nga Gaza duke vlarë qindra të rinj me automatikë, e duke marrë pengnjë numër të panjohur prej tyre në Gaza.

Festa nisi rreth mesnatës dhe duhej të zgjaste deri dje pasdite, shpjegon Arik. “Rreth orës gjashtë të mëngjesit, ndërsa ishim në kulmin e festës, befaz u gjendëm të rrethuar nga raketa, pamë dhjetëra raketa që fluturonin rreth nesh. Shpërtheu paniku”.

Ariku dhe shoku me të cilin shkoi në festë arrijnë deri tek makina e tyre. Ata përpiqen të largohen, por shpejt e gjejnë veten të bllokuar. “E

lamë makinën dhe vazhduam në këmbë. Raketat vazhdonin, por në atë moment filluam të dëgjojmë të shtëna automatiku. Ishim dy-tre mijë veta që po iknim, ndërsa na gjuanin nga të gjitha drejtimit dhe ishim të rrethuar me raketa”.

Ariku dhe të tjerët përpiqen me dëshpërim të gjejnë strehë. “Mendova se do të vdisja, por papritmas pamë një hendek dhe u hodhëm në të. U fshehëm në një kaçubë ferrash, mund të shihnim plumbat që fluturonin mbi kokat tona. Ndërsa isha duke ikur, mora një celular në tokë dhe papritmas filloi të binte zilja, duke rrezikuar se do të zbulonte pozicionin tonë, por arrita ta fikja”.

Pas një ore në kanal, djemtë vendosin të lëvizin dhe të kërkojnë një vend më të sigurt.

“Ecëm rreth pesëmbëdhjetë kilometra derisa më në fund gjetëm një makinë që na çoi në një vend relativisht të sigurt – përveç raketave që vazhdonin.”

Arik shpjegon: “Ishte eksperiencia më e keqe e jetës sime”. I riu, një profesionist marketingu, flet nga shtëpia e vëllait të tij në Tel Aviv. “Nuk dua të jem vetëm në një moment si ky,” shpjegon ai. “Po përpiqem gjithashtu të mos shikoj lajmet, të kaloj këtë moment të vështirë, por gjithçka që mund të mendoj janë të gjithë miqtë që janë zhdukur, që janë rrëmbyer, që kanë vdekur. Ishim thjesht një



grup të rinjsh, pothuajse të gjithë ishim midis njëzet dhe tridhjetë vjeç, donim të argëtoheshim, nuk lënduam askënd”.

Prej ditës së djeshme telefoni i Arikut nuk ka reshtur së rëni. “Shumë njerëz më telefonojnë, duan lajme për të dashurit e tyre, por unë nuk di asgjë. Kaq shumë prej nesh kanë ikur në drejtime të ndryshme, sa nuk kam asnjë lajm për të dhënë”.

Kur trupat izraelite mbërritën në zonë, ata e gjetën veten duke luftuar me dhjetëra terroristë, në një betejë shumë të ashpër, ku



fillimisht oficerët e policisë luftuan kundër terroristëve të Hamasit të pajisur më mirë. Vetëm rreth orës dy të mëngjesit të ditës së diel erdhën parashutistët dhe morën kontrollin, ndonëse gjatë ditës mendohej ende se kishte militantë të fshehur në shkurre në zonë.

Pas luftimeve, skena që u shfaq para policisë dhe personelit mjekësor ishte vërtet apokaliptike, me dhjetëra automjete të braktisura dhe të bëra shoshë nga plumbat, përfshirë furgonat e bardhë të përdorur nga terroristët,

brenda të cilëve u gjetën kallashnikovë, granata, jelekë antiplumb dhe kopje të Kuranit, sipas gazetës izraelite Ynet, dhe më pas rreshta e rreshta trupash ende pa emër.

Në mbrëmje, Zaka, organizata që merret me trupat e atyre që bien në sulme terroriste, foli për 260 kufoma. “Jemi shpesh të njëjtët njerëz që shkojmë në këto festa, jemi më shumë se një komunitet, jemi si një familje”, përfundon Arik. “Ideja që kaq shumë nuk do kthehen, më thyen zemrën.” / La Repubblica – Bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Gliha: Andorra, një kundërshtare e vështirë

Përzgjedhësi i Kosovës, Primoz Gliha, para ndeshjes me Andorrën ka deklaruar se kjo kombëtare është mjaft e fortë. Gliha thotë se mungesat e shumta në formacionin e “dardanëve” janë një mundësi e mirë për lojtarët e rinj që të dëshmojnë në përfaqësuese. Kosova përballet me Andorrën të enjten, ndërsa ndeshja kundër Izraelit mund të anulohet

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll i zhvillon dy ndeshje kualifikuese për Kampionatin Evropian ndaj Andorrës dhe Izraelit. “Dardanët” më 12 tetor përballen në “Andorra la Villa” me Andorrën, ndërsa ndeshja me Izraelin mund të shtyhet për shkak të luftimeve në Lindjen e Mesme, por vendimin final ende nuk e ka dhënë UEFA.

Në konferencën për medie përzgjedhësi i Kosovës, Primoz Gliha, ka vlerësuar Andorrën si një kundërshtare mjaft të fortë për faktin se ka pasur rezultate të mira dhe se ka një mbrojtje mjaft të fortë. “Në këtë situatë në të cilën jemi aktualisht pothuajse kemi një ekip të ri, ngaqë kemi shumë mungesa. Andorra është ekip goxha i vështirë për të luajtur, ngaqë luan mbrojtje shumë të ngjeshur dhe është e vështirë t'i shënosh gol. Andorra luajti 0:0 me



Bjellorusinë, 1:1 me ne, Zvicra ka fituar 2:1, ndërsa me Izraelin deri në minutën e 70 ishte 1:1. Mirëpo në futboll asnjëherë nuk e dimë çfarë mund të ndodhë. Për mua është e rëndësishme që futbollistët nga Superliga e Kosovës dhe ata të cilët nuk kanë pasur mundësi të luajnë shumë deri më tash të tregojnë lojë të mirë sepse kjo është shumë e rëndësishme për të ardhmen e

këtij ekipi”, ka thënë Gliha, i cili ka konfirmuar se ka mungesa për këtë ndeshje, por kjo do të jetë në të mirë të lojtarëve të rinj që do të kenë mundësinë që të luajnë. “Ne aktualisht pothuajse e kemi një ekip me lojtarë të rinj, janë përfshirë disa lojtarë të Superligës. Kemi mungesa të shumta, por është një mundësi e mirë për lojtarët e rinj që të na bindin në të ardhmen që të jenë pjesë e përfaqësueses. Kjo situatë është e mirë për lojtarët e rinj për ta pasur mundësinë e tyre. Ne kemi shumë mungesa dhe pasi nuk kemi më gjasa për kualifikim. Do ta kemi mundësinë t'ua japim rastin lojtarëve të rinj. Ne po flasim për ekipin kombëtar dhe është niveli më i lartë që përfaqësohet shteti, prandaj lojtarët e rinj duhet ta dëshmojnë veten edhe në situata të tilla. Duhet ta ndjekim një shembull si

Luksemburgu, i cili ka 11 pikë më duket”, ka shtuar Gliha. Ndërsa lëndimin e tre futbollistëve e ka konfirmuar menaxheri i Përfaqësueses së Kosovës, Bajram Shala, kurse edhe Edon Zhegrova është në dyshim. “Të dielën u lëndua Ismail Beka. Përveç tij janë të lënduar Shkëlqim Vladi dhe Leart Paqarada, kurse jemi ende në pritje të Edon Zhegrovës që, po ashtu, pati një problem me një lëndim. Është duke kryer testet para se të merret vendimi definitiv. Pas ndeshjeve të fundjavës Vojvoda do t'i bashkohet listës”, ka thënë Shala. Përzgjedhësi Gliha e ka ftuar mbrojtësin e skuadrës së Torinos, Mërgim Vojvoda. Kosova aktualisht është në vendin e fundit në Grupin I me vetëm katër pikë të grumbulluara nga gjashtë ndeshjet e zhvilluara.

Balkani: Trajneri Daja është sulmuar në ndeshjen ndaj Prishtinës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 TETOR - Trajneri i Ballkanit, Ilir Daja, është sulmuar të dielën në ndeshjen ndaj Prishtinës që është zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”. Këtë lajm e ka dhënë skuadra e Ballkanit në faqen zyrtare në “Facebook”. Ndeshja derbi në mes të këtyre dy skuadrave ka përfunduar me rezultat 1-1. Klubi kampion i ka marrë me shqetësim skenat që ndodhën në stadiumin “Fadil Vokrri” në kryeqytet në ndeshjen ndaj Prishtinës. “Trajneri ynë, Ilir Daja, ka qenë cak i sulmeve të

vazhdueshme verbale, por edhe fizike nga persona që në stadium nuk ishin për futboll, por për qëllime të tjera jospportive. Në përfundimin e pjesës së parë vëllai i një zyrtari të klubit vendas ka hedhur shishe në drejtim të trajnerit Daja. Duke mos u ndalur me kaq, fatkeqësisht para syve të sigurimit, ai dhe disa të tjerë në vazhdimësi kanë qëndruar mbi bankinën ku ishte skuadra jonë, duke ofenduar e kërcënuar trajnerin dhe stafin tonë teknik”, thuhet në njoftimin e Ballkanit. Skuadra nga Suhareka e indinjuar nga kjo ngjarje ka kërkuar nga organet kompetente si brenda ashtu edhe jashtë Federatës, që ta

trajtojnë me seriozitet këtë situatë sepse futbollin po mundohet ta dërgojë sa më shumë përpara, derisa gjërat e tilla e kthejnë prapa. “Puna e madhe e FC Ballkanit, përfshirë trajnerin Daja dhe futbollistët tanë, u ka sjellë dobi krejt ekipeve të Superligës, në këtë rast edhe vetë Prishtinës, andaj është e pakuftueshme të lejohen lëshime të tilla”, ka njoftuar klubi suharekas.

Trajneri Ilir Daja ka pasur suksese të jashtëzakonshme duke u shpallur dy herë kampion i Kosovës dhe duke siguruar për të dytin vit radhazi kualifikimin historik në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës.



Ramadani: Kemi edhe tri finale, ndaj Çekisë luajmë për fitore

TI RANË, 9 TETOR - Shqipëria po bëhet gati për sfidën me Republikën Çeke, e vlefshme për kualifikueset e Evropianit “Gjermani 2024”. Mesfushori i Kombëtares, Ylber Ramadani, u shpreh se skuadra do të kërkojë ta marrë maksimumin nga kjo ndeshje aspak e lehtë. “Nëse arrijmë Evropianin është një gjë e madhe për mua, për gjithë Shqipërinë, për familjen time. Atje në Itali jam duke bërë mirë dhe besoj të vazhdoj kështu. Kemi ardhur me mentalitetin e duhur. Kur e kemi mbaruar ndeshjen me Poloninë, një ndeshje e vështirë. Me Çekinë është ndeshje e vështirë gjithashtu. Kanë pësuar vetëm dy

gola. Duhet të hyjmë me qasjen e duhur, pa eufori dhe ta marrim rezultatin pozitiv. Normalisht ndeshja në shtëpi është më ndryshe. Kemi tifozët tanë që na përkrahin dhe ne do të hyjmë që ta fitojmë ndeshjen. Unë isha i fokusuar te ndeshja me Sasuolon sepse edhe na duhen pikë atje. Por kur mbaron ajo ndeshje vëmendja kalon automatikisht te Kombëtarja. Është hap i madh për mua sepse Seria A është kampionati i dytë më i fortë që në botë. Këtu ku jam dua ta jap maksimumin. Shpresoj që dhe me Çekinë ta jap maksimumin. Kë do ta tërhiqja në kampionatin italian?”



Të gjithë. Që ta bëjmë skuadrën sa më të fortë”, ka thënë Ramadani. “Ne do hyjmë për më shumë sepse kemi tri finale. Do të hyjmë ta bëjmë maksimumin dhe e dimë se

çfarë na pret po morëm rezultatin pozitiv. Siç thashë, janë tri finale. Llogaritë do të bëhen më vonë. Sikur edhe dy ndeshjet e tjera do të shpresojmë të bëjmë mirë. Llogaritë do t'i bëjmë në fund. Ne jemi profesionistë. Çdoherë ka presion në çdo ndeshje. Nuk duhet të bëjmë ndonjë gjë që të na dëmtojë. Nga minuta e parë duhet të tregojmë kujdes. Çekia është në vendin e dytë dhe janë ekip më të fortë fizikisht. Normalisht që është kundërshtari direkt”, ka shtuar Ramadani. Mesfushori i Lecces foli edhe për interesimin e madh të tifozëve për këtë ndeshje. Ai shpreson se nuk

do t'i zhgënjëjnë tifozët, të cilët po e mbështetin maksimalisht kombëtaren. “Kjo do të thotë që është përkrahje shumë e madhe për ne dhe shpresojmë mos t'i zhgënjëjmë. Të bëjmë si në ndeshjen e fundit. Dua t'i falënderoj të gjithë shqiptarët anembanë ku janë që vijnë të na mbështesin. Duhet t'ia kthejmë në fushë. Do t'u lutesha tifozëve të mos hedhin gjëra në fushë sepse ata janë lojtari i 12 yni dhe na duhen për ndeshjet e radhës. Kjo do të ishte mirë që të jenë me ne gjithmonë. Nuk duam t'i humbim për këto hedhje në fushë”, u shpreh Ramadani.

Kosova U17 promovohet në Ligën A në kualifikimet për 'Euro 2024'

Prishtinë, 9 tetor - Përfaqësuesja e Kosovës U17 në konkurrencën e vajzave ka fituar minuturneun kualifikues të Grupit 1 në Ligën B për kualifikimet e Kampionatit Evropian "Suedia 2024", i cili gjatë ditëve të fundit u organizua nga Federata e

Futbollit e Kosovës. Pas barazimit me Andorrën dhe fitores me Gjeorgjinë, vashat "dardane" shënuan fitore në ndeshjen e tretë dhe përcaktuese për pozitën e parë ndaj Maqedonisë së Veriut, me rezultat 2-1, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil

Vokri". Të parat në epërsi kaluan mysafiret me golin e Kalina Popeski në minutën e 10. Megjithatë, baraspeshën në rezultat e riktheu Rita Feka në minutën e 27 (1-1), me të cilin rezultat edhe u mbyll pjesa e parë. Në pjesën e dytë Dardanet ishin edhe më këmbëngulëse

drejt portës mysafire, të vetëdijshme se vetëm fitorja kryente punë, pasi Maqedonia e Veriut në dy ndeshjet e para kishte shënuar fitore. Punët për të përzgjedhurat e Sanije Krasniqit u lehtësuan pas përjashtimit të Komnenovës në minutën e 68. E këtë epërsi numerike në fushë



Dardanet e kaptalizuan në minutën e 84-t, me golin e Liza Hoxhës, duke vulosur fitoren në këtë ndeshje me shifrat 2-1.

Avdyli, 'Ylli i javës' në Superligën e futboll

PRISHTINË, 9 TETOR - Portierit të Llapit, Ilir Avdyli, i ka takuar çmimi "Ylli i javës" për javën e 9, i cili jepet nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit, në përbërje: Bujar Guta, Luan Tabaku, Arton Hajdari.

Ky komision vendosi që portieri i KF Llapit, Ilir Avdyli, të shpallet "Ylli i Javës" sepse gjatë gjithë lojës ishte në nivelin e detyrës, po ashtu kur skuadra e tij ishte me një lojtar më pak e mbrojti penalltinë dhe ishte më meritor i që Llapi mori 3 pikë të plota.

Çmimin "Ylli i javës" për futbollistin e KF Llapit Ilir Avdyli e dha Benjamin Geci, menaxher marketingu në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim portieri i Llapit u shpreh i lumtur që u vlerësua kontributi i tij në këtë ndeshje tejet të rëndësishme dhe të



vështirë, për faktin se në një periudhë të madhe të lojës luajti me një lojtar më pak, madje disa minuta edhe me dy lojtarë më pak. "Jam shumë i lumtur që jam shpallur më i miri i xhiros së 9, sidomos në një ndeshje kaq të luftuar siç ishte kjo me Lirinë. Është gjithmonë kënaqësi të arrish të mbrosh një penallti e ta ndihmosh ekipin me tri pikët e

radhës. Aktualisht pas përmblyljes e fazës së parë, Llapi gjendet në pozitën e dytë me vetëm një pikë pas Ballkanit dhe besoj që me punën që po bëjmë jemi në rrugën e duhur për t'i arritur objektivat tona. Falënderoj bashkëlojtarët dhe stafin për punën që po e bëjmë bashkërisht", ka thënë Avdyli për faqen zyrtare të FFK-së.

Seferi: Ndaj Çekisë duhet ta japim shpirtin në fushë dhe të luajmë me zemër

TIJANË, 9 TETOR - Sulmuesi i Kombëtares kuqezi, Taulant Seferi, në konferencën për shtyp në prag të ndeshjes me Çekinë me datën 12 tetor, është shprehur se do të jetë një ndeshje shumë e fortë, por skuadra do ta jap maksimumin në fushë. "Ka konkurrencë, ne kemi grup të fortë. Për sa i përket kush do të luajë e vendos trajneri, ne na ngelet që vetëm të punojmë shumë dhe e shohim pastaj kush do të startojë apo jo. Janë tri finale, por fokusi ynë është te kjo ndeshje. Dashtë Zoti të dalim me rezultat pozitiv, pastaj do të shohim për ndeshjet e radhës. Besoj që po pasi kemi bërë shumë gola, dhe kjo është ofensiva më e mirë që ka pasur kombëtarja, kjo më bën të lumtur, konkurrenca na shërben



për rezultate pozitive", ka thënë Seferi. "Kur Kombëtarja shënon është diçka e bukur për sulmuesit, por kombëtares nuk e bën reparti, por të gjithë bashkë. Motivim shtesë është kur shënon, ne sulmuesit luajmë për të bërë gola,

jemi të lumtur kur shënojmë, erdhi koha të shënoj edhe me Shqipërinë. Ne duhet ta kemi shpirtin luftarak ndaj Çekisë dhe tifozët tanë na bëjnë më të fortë. Iu lutem tifozëve mos të hedhin flakadanët, dhe te kjo ndeshje na duhet përkrahje, duhet të kenë kujdes dhe për sendet që hedhin në fushë sepse do të dënohen ata dhe ne penalizohemi. Çekia është kundërshtarja më e fortë e këtij grupi për ne, Çekia nuk është vetëm Schick duhet të kemi kujdes. Duhet të japim shpirtin në fushë dhe të luajmë me zemër. Shqipëria tani futet për maksimumin, por besoj që kemi grupin e duhur. Jemi të karikuar. E kemi forcën e duhur", ka shtuar Seferi.

SHKURT

KB Peja përforcohet me Jordan Barnes

Skuadra e Pejës ka njoftuar se përforcimi më i ri në radhët e saj do të jetë Jordan Barnes. Këtë kampioni aktual i Kosovës në basketboll e ka bërë me dije në rrjete sociale. "Gjithçka zyrtare, Jordan Barnes është përforcimi i ri i KB Peja. Welcome Jordan! Ma eger se vjet!", thuhet në njoftimin e klubit pejan. Peja ndeshjen e javës së tretë e zhvillon të enjten nga ora 18:00 kundër Trepçës.

Zhegrova në formacionin e javës në Ligën 1

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Edon Zhegrova, edhe në xhiron e tetë të Ligës 1 në Francë tregoi formë të mirë. 24-vjeçari krahas lojës së bukur dhuroi edhe një asistim për Andren në ndeshjen që Lille barazoi si mysafir i Lensit. Për shkak të performancës së mirë në këtë takim, Zhegrova është përfshirë në formacionin e javës në Francë.

Formacioni: Kohn, Hakimi, Todibo, Maripan, Yongwa, Andre, Boudaoui, Jeffinho, Zhegrova, Kroupi, Aubameyang.

Guardiola: Kurrë nuk më ka kërkuar Juventus

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ishte i ftuar në një event për sa iu përket talenteve të futbollit, me teknikun spanjoll që u ndal të fliste për një histori të vjetër me Juventusin. Katalanasi u përfol se do t'i drejtonte bardhezinjtë në vitin 2019 dhe duket se ai ka vendosur t'i thyejë akujt dhe ta tregojë të vërtetën. "Nuk më kanë kërkuar kurrë. A do të drejtoj ndonjë ditë në Itali? Më pëlqen shumë si vend. Ushqimi është shumë i mirë dhe shkoj shpesh për t'i kaluar pushimet. Nuk e kam ndjekur së fundmi futbollin italian, por jam i sigurt se ka shumë talente", u shpreh Guardiola.

Lukaku: Njerëzit flasin, unë përgjigjem në fushë

Romelu Lukaku ka shfaqur lojë të mirë dhe ka shënuar dy gola në ndeshjen që Roma e fitoi me rezultat 4-1 ndaj Cagliariarit. Sulmuesi belg thotë se Roma është Romë dhe nuk mund të thuhet se Roma është e Lukakut. "Jo, Roma është Romë. Duhet të përmirësohemi. Jemi në një pozitë të vështirë, por po rritemi. Ne duhet të bëjmë më mirë për tifozët dhe për qytetin. Ne kemi një popull të tërë pas nesh. Jam i lumtur për fitoren", ka thënë Lukaku. "Unë jam profesionist. Kam punuar këtë verë, ndërsa njerëzit po flasin. Unë tregoj se çfarë mund të bëj në fushë", u shpreh Lukaku. Në tetë ndeshje me Romën, Lukaku ka shënuar shtatë gola, pesë në Serinë A dhe dy në Ligën e Evropës.


Arteta pas fitores ndaj Cityt: Mposhtëm skuadrën më të fortë në botë

LONDËR, 9 TETOR - Skuadra e Arsenalit e ka mposhtur në derbi Manchester Cityn (1-0). Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, është shprehur i lumtur me këtë fitore ndaj rivalit kryesor për titullin e kampionit, duke thënë se

kanë mposhtur skuadrën më të fortë në botë. "Atmosfera është e jashtëzakonshme. Duket që kishim vite pa fituar ndaj Cityt. Mendoj se mposhtëm skuadrën më të fortë në botë. E bëmë këtë në

mënyrën më të shkëlqyer. Kishte momente gjatë ndeshjes në të cilat vuajtëm shumë, por kishte edhe momente që treguam dëshirën për t'i marrë pikët e plota", ka thënë Arteta. "Jam shumë i lumtur dhe kjo

fitore shërben edhe si një mesazh për lojtarët që të besojnë në atë çfarë po bëjnë sepse janë një grup fantastik. Ekipi tregoi shumë maturi. Kemi fituar përvojë dhe jemi përmirësuar", u shpreh Arteta.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Jemin Muhadri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Pjetër Bogdani 2".

- Blerim Muhadri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Pjetër Bogdani 2".

- Gjergj Lleshdedaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit "AAB", drejtimi: Banka, Financa dhe Kontabilitetet.

- Akil Bakija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme amerikane "Amerikan School of Kosova", ASK.

- Arsim Ajdini shpall te pavlefshme 3 dëftesat Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Vullnet Vraniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q. K "11 Marsi" Prizren.

- Ardit Ademaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q. K. "11 Marsi" Prizren.

- Endrit Qovana shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.

- Egzona Rrustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XX si dhe Diplomen e Gjimnazit "Naim Frashëri" Shtime.

- Eliza Hajrullahu shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Dymbëdhjetë si dhe diplomën e Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë,

shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

